

Përjetim i kujtimeve

**dhe marrja përsipër
e përgjegjësisë**

PËRVJETORI I 70.
I NDËRTIMIT TË KAMPIT
TË PËRQËNDRIMIT
BUCHENWALD

PËRVJETORI I 70.
I NDËRTIMIT TË KAMPIT
TË PËRQËNDRIMIT
BUCHENWALD

I. Të burgosurit e atëhershëm të kampit të përqëndrimit Buchenwald (Buhenvald) i drejtohen përfaqësuesëve të qytetit Weimar (Vajmar):

Ne e kemi mbijetuar kp Buchenwald. Ne u betuam, se do ta ndërtonim një botë të re të paqës dhe të lirisë, duke dëshmuar gjatë jetës sonë mbi krimet e Gjermanisë naziste. Ne i kemi shtjelluar arsyet për këto krime dhe me plot qartësi i kemi bërë të ditur përgjegjësit. U angazhuam dje dhe po angazhohemi edhe sot, në mënyrë që të evitohet rikthimi i këtyre krimeve. Megjithatë, në ndërkohë shumë nga ne kanë shkuar, ne jemi të fundit, me shkuarjen tonë do të zhduket edhe kujtimi i gjallë i sundimit barbar dhe i terrorit i nacional-socialistëve.

Kur shkojmë sot, 70 vjet pas ndërtimit të kampit edhe një herë në këtë vend – në vendin ku nazistët fillimisht i mbanin me zor të mbyllur gjermanët, duke vazhduar më pastaj t’i çonin atje me forcë edhe luftëtarët e rezistencës dhe kundërshtarët e Gjermanisë naziste nga të gjitha shtet e pushtuara dhe më në fund edhe çifutët, sinti dhe romët, të cilët duhej të çfaroseshin – atëherë na mundon pyetja, më shumë se kur më parë: kush do të flasë për krimet e nazistëve, kush do t’i qëndrojë karshi neonazistëve dhe të gjithë përbuzësve të demokracisë dhe të dinjitetit njerëzor? Kush do të flasë dhe do të luftojë për neve, kur ne nuk do të jemi më?

II. Përfaqësuesit e qytetit Weimar deklarojnë duke ju drejtuar të burgosurve të kampit të përqëndrimit Buchenwald:

Ne asnjëherë nuk do të heshtim në lidhje me krimet e nacional-socialistëve. Ne dimë, që historia e qytetit tonë është e lidhur me zhvillimin e një botëkuptimi humanist njerëzor, me themelimin e demokracisë, mirëpo edhe me shkatërrimin e tërë dinjitetit njerëzor. Ndarja nga ata, që edhe sot mund të dëshmojnë për krimet e nazistëve, nuk do të jetë ndarje nga ballafaqimi kritik me krimet e nazizmit. Jemi koshient për përgjegjësinë që kemi, në mënyrë që të mbahen gjallë kujtimet, duke i vazhduar ato brez pas brezi.

Ju përshëndesim si qytetarë të barabartë në qytetin Weimar. Ardhja juaj dëshmon se sa i domosdoshëm është dhe duhet të jetë fiksimi i përbuzjës së botëkuptimeve national-socialiste dhe i shfaqjeve të tyre aktuale në demokracinë tonë. Fati Juaj, guximi Juaj, vullneti Juaj për rezistencën, edhe më tutje do të na shtyejnë, që t'i kundërshtojmë fuqishëm të gjitha format e rikthimit të asaj, që ju ka çuar drejtë fatkeqësisë Juve, që i ka çuar drejtë fatkeqësisë vendet tuaja dhe më në fund edhe vetë Gjermaninë.

Për këtë arsye, qyteti i Weimar-it sot do të bëhet udhërrëfyes, duke siguruar se do të angazhohet në mënyrë që amaneti Juaj të jetë pjesë dhe të qëndrojë si pjesë në mënyrë të qëndrueshme, e thelbit të vetëkuptimit demokratik dhe të kulturës politike të Republikës ferale të Gjermanisë. Idetë nacional-socialiste, racizmin dhe antisemitizmin do ta luftojmë gjithmonë me të gjithë fuqinë. Ne dimë, që të drejtat e njeriut, liria dhe demokracia, nuk janë gjëra të vetëkuptueshme, por që duhet të jetojnë gjithmonë përseri dhe të mbrohen çdo ditë.

Bertrand Herz

PRESIDENT I KOMITETIT NDËRKOMBËTAR
BUCHENWALD-DORA DHE KOMANDOTË

Stefan Wolf

KRYEBASHKIAKU
I QYTETIT WEIMAR

III. Firmosja e deklaratës „Përjetim i kujtimeve dhe marrja përsipër e përgjegjësisë“ nga këshilli i qytetit Weimarer Stadtrat në korrik 2007:

WALTER BOURQUAIN

BRIGITTE BURCKHARDT

RAINER DÖNNECKE

DR. DIETER ECKARDT

DR. GERT EISENWINDER

HEINZ FISCHER

HARALD FREUDENBERG

MONIKA GLIMM

CORINA HARKE

DR. THOMAS HARTUNG

MICHAEL HASENBECK

HORST HASSELMANN

DR. HANS HEUZEROTH

PROF. DR. WOLFGANG HÖLZER

STEPHAN ILLERT

RUDOLF KESSNER

RALF KIRSTEN

ROBERTO KOBELT

KARL-HEINZ KRAASS

MARTIN KRANZ

DR. PETER KRAUSE

SIEGRUN LOPP

CARSTEN MEYER

DIRK MÖLLER

DR. BERND NOWAK

REGINA PEESS

HARTMUT POHLE

ANNETTE PROJAHN

KLAUS-PETER RUHLAND

KATJA SCHÄFER

MARTINA SCHENK

CLAUS SCHINNER

VRONI SCHMIEDEL

NORBERT SCHREMB

GERHARD SCHWARTZE

GÜNTER SEIFERT

PETRA STREIT

JOACHIM TROMMSDORF

JÜRGEN VENT

STEFFEN VOGEL

PROF. DR. FRANK WERNER

FRANK ZIEGLER

